



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1696/4 Prot.

Tiranë, më 28.12.2017

VENDIM

Nr.245, datë 28.12.2017

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 98, DATË 25.04.2017
NË INSTITUCIONIN E BASHKISË PUKË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 98, datë 25.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Pukë”.

KONSTATOVA SE:

Me Vendimin Nr. 44, datë 19.04.2016, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Pukë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Bashkinë Pukë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 98, datë 25.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Pukë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Pukë, si pjesë përbërëse të këtij vendimi, dhe të kërkoj nga njësia përgjegjëse që për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë të kryejë detyrat si më poshtë:
2. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Pukë, për punonjësit e mëposhtëm:

- ✓ ******, emëruar me aktin nr. 45, datë 01.10.2007, në pozicionin “Specialist Veteriner dhe Përgjegjës i Pastrim Gjelbërimit”;
- ✓ ******, emëruar me aktin nr. 05, datë 01.02.2011, në pozicionin “Specialiste e Ndhmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Shoqërore”;
- ✓ ******, emëruar me aktin nr. 188, datë 04.12.2013, në pozicionin “Specialiste e Tatim Taksave”;

të nxjerrë aktet e deklaramit të statusit të punësimit, “Nëpunës civil” apo “Nëpunës civil në periudhë prove”, në varësi të kohës së punësimit në dt. 26.02.2014, pasi të verifikohet përmbushja e kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesat e përgjithshme e ato të veçanta që përmban secili prej vendeve të punës.

3. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë, të përfundojë marrëdhëniet e punësimit, duke evidentuar në aktin përkatës, faktin e mospërmbushjes së kriterit të nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit të cilët janë me arsim të mesëm, ose që nuk plotësojnë kriterin arsimor për vendin e punës, si më poshtë:

- ✓ ******, emëruar në datën 01.03.1998, në pozicionin “Arkiviste”;
- ✓ ******, emëruar me aktin nr. 118, datë 04.12.2013, në pozicionin “Specialiste Teknike”.

4. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë, të drejtojë procesin për anulimin nga ana e organit publik që i ka nxjerrë, të akteve të emërimit, që kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit, sipas kërkesave të neneve 22, e vijues të këtij ligji, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës, për punonjësit e përmendur më poshtë:

- ✓ Të anulojë aktin nr. 151, datë 06.10.2015, për emërimin e ******, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Zhvillimit të Turizmit dhe Mardhënieve me Publikun”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 169, datë 16.10.2015, për emërimin e ******, në pozicionin “Specialist IT dhe Zhvillimit të Turizmit”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 54, datë 04.08.2015, për emërimin e ******, në pozicionin “Drejtor Finance”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 59, datë 11.03.2016, për emërimin e ******, në pozicionin “Specialiste Finance”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 110, datë 15.10.2014, për emërimin e ******, në pozicionin “Specialist Finance”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 195, datë 20.11.2015, për emërimin e ******, në pozicionin “Specialist Finance”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 189, datë 09.11.2015, për emërimin e ******, në pozicionin “Punonjëse Sociale”;

- ✓ Të anulohet aktin nr. 62, datë 11.03.2016, për emërimin e ***** në pozicionin "Inxhinier Ndërtimi";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 130, datë 18.09.2015, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist Pyjesh";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 60, datë 11.03.2016, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist Bujqësie".

Pozicionet e punës në lidhje me rastet e sipërpërmendura, duhet të konsiderohen pozicione të lira, dhe të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në koherencë me nevojat dhe strukturën aktuale të Bashkisë Pukë.

5. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë, të anulohet aktet e emërimit, që kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit, të kërkuar nga nenet 22, e vijues të këtij ligji, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës, për punonjësit e përmendur më poshtë, të ndarë sipas njësive administrative:

- Në Njësinë Administrative Gjegjan:

- ✓ Të anulohet aktin nr. 197, datë 20.11.2015, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist i Tatim Taksave";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 196, datë 20.11.2015, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialiste e Ndihmës Ekonomike";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 69, datë 18.03.2016, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist Pyjesh";

- Në Njësinë Administrative Qerret:

- ✓ Të anulohet aktin nr. 173, datë 22.10.2015, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialiste e Ndihmës Ekonomike";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 134, datë 28.04.2016, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialiste e Arkiv Protokoll";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 135, datë 28.04.2016, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist Pyjesh dhe Bujqësisë";

- Në Njësinë Administrative Qelëz:

- ✓ Të anulohet aktin nr. 121, datë 18.09.2015, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist Finance";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 113, datë 14.04.2016, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialist i Ndihmës Ekonomike";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 113, datë 14.04.2016, për emërimin e ***** në pozicionin "Specialiste e Arkiv Protokoll";

- Në Njësinë Administrative Rrapë:

- ✓ Të anulohet aktin nr. 76, datë 04.09.2015, për emërimin e *****, në pozicionin "Specialiste Finance";
- ✓ Të anulohet aktin nr. 127, datë 18.09.2015, për emërimin e *****, në pozicionin "Specialist i Tatim Taksave".

Pozicionet e punës në lidhje me rastet e sipërpërmendura, duhet të konsiderohen pozicione të lira, dhe të merren masat e nevojshme për plotësimin e tyre në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në koherencë me nevojat dhe strukturën aktuale të Bashkisë Pukë.

6. Të trajtohen si pjesë e shërbimit civil dhe të plotësohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas kërkesave të neneve 22, 23, 24, e vijues të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në përputhje me dinamikën dhe nevojat që paraqet struktura aktuale, apo ajo që pritet të miratohet këto pozicione pune;

- Në bashkinë Pukë;

- ✓ Përgjegjës i Sektorit Urbanistik dhe Regjistrimit të Pasurive
- ✓ Përgjegjës i Sektorit të Auditi të Brendshëm
- ✓ Specialist Auditues i Brendshëm
- ✓ Specialist Auditues i Brendshëm

- Në komunën Qerret;

- ✓ Specialist i Ndihmës Ekonomike
- ✓ Specialist Teknik Topograf
- ✓ Specialist Tatim Taksash

7. Njësia e burimeve njerëzore pranë Bashkisë Pukë, duhet të hartojë menjëherë përshkrimet e punës për gjithë pozicionet që i përkasin shërbimit civil, sipas formatit standard të miratuar, siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

8. Njësia përgjegjëse dhe drejtuesit e institucionit Bashkia Pukë, të marrin masat për kryerjen e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për të gjithë punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, i gjeti në punë dhe sipas nenit 67 të ligjit në fjalë përfituan statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit. Ky proces duhet të kryhet edhe për vitet 2015 dhe 2016. Formularët e vlerësimit të punës duhet të hartohen sipas formatit të miratuar dhe në mbështetje

të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë". Formularët e plotësuar dhe të nënshkruar nga zyrtarët përkatës, duhet të depozitohen pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, duke iu komunikuar edhe nëpunësit përkatës.

9. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë, duke respektuar kërkesat e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimin të shërbimit civil", të fillojë menjëherë të evidentojë nevojat për rekrutime të reja, nisur nga pozicionet e lira aktuale, por duke patur parasysh edhe ndryshimet e mundshme në personel, që mund të pasojnë miratimin e strukturës përfundimtare për vitin 2017.

Në vijim të realizimit të kësaj detyre, në zbatim të nenit 2, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të veprojë për përfshirjen në shërbimin civil të pozicioneve të mëposhtme (ndarë sipas njësive administrative):

- Në Njësinë Administrative Qerret, pozicionet e punës:

- ✓ "Specialist i Tatim Taksave"
- ✓ "Specialist i Ndhmës Ekonomike".

- Në Njësinë Administrative Rrapë, pozicionet e punës:

- ✓ "Arshivë dhe Protokoll"
- ✓ "Përgjegjës Financës"
- ✓ "Përgjegjës i Shërbimit Pyjor, Ndhmës Ekonomike dhe Kadastrës"
- ✓ "Inspektor i Tatim Taksave dhe Emergjencave Civile".

10. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë, të përfundojë marrëdhëniet e punësimit, duke evidentuar faktin e mospërmbushjes së kriterit të nivelit arsimor për shkak se janë me arsim të mesëm, ose nuk plotësojnë kriterin arsimor sipas kërkesave specifike të pozicioneve të punës, për punonjësit e mëposhtëm:

- Në Njësinë Administrative Gjegjan:

- ✓ ******, emëruar me aktin Nr. 10, datë 23.04.2010, në pozicionin "Arkivist"

- Në Njësinë Administrative Rrapë:

- ✓ ******, në pozicionin "Arshivë dhe Protokoll"

Pozicionet e punës në lidhje me rastet e sipërpërmendura, duhet të konsiderohen pozicione të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Pukë.

- 11.** *Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë, për rregullimin e ligjshmërisë në rastin e nëpunëses *****, meqenëse kjo punonjëse nuk është ankuar në organet kompetente ndaj veprimit administrativ të realizuar me aktin nr.610/10, dt. 09.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë, duhet të plotësojë mangësitë e aktit administrativ në respektim të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe t'i japë shpërblimin sipas vjetërsisë në shërbimin civil.*
- 12.** *Të plotësohen dosjet e personelit, sipas konstatimeve të evidentuara në aneksin nr. 1 "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar" dhe aneksin nr. 2 të Raportit Përfundimtar "Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil".*
- 13.** *Me hartimin e strukturës përfundimtare, njësia përgjegjëse, për Njësitë Administrative duhet të bëjë një ndarje të qartë mes pozicioneve që përfshihen në shërbimin civil dhe njësive direkte të shërbimit, të cilat nuk janë pjesë e shërbimit civil.*
- 14.** *Për të rregulluar ligjshmërinë e veprimeve të kryera gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit, duhet të vepohet si më poshtë:*
 - *Së pari, njësia përgjegjëse e Bashkisë Pukë, duhet të përfundojë procesin e deklarimit të statusit të punësimin për të gjithë punonjësit e prekur nga procesi i ristrukturimit.*
 - *Së dyti, për punonjësit që nuk i përmbushin kërkesat për të qenë nëpunës civil, të refuzohet deklarimi i statusit të nëpunësit civil dhe të ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të ligjit, duke patur në konsideratë edhe sa është urdhëruar më sipër.*
 - *Së treti, për shkak të mosrespektimit të procedurave ligjore që rregullojnë procesin e ristrukturimit, Njësia Përgjegjëse e institucionit duhet të drejtojë procesin për kryerjen e veprimeve përkatëse për revokimin e gjithë akteve administrative që kanë dalë deri në këtë moment në lidhje me këtë proces, në*

kundërshtim me ligjin, dhe të fillojë procesin nga e para, duke ndjekur radhën e mëposhtme të punës:

- a) *Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit, duke u kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili, bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka të drejtë të propozojë sistemin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke krahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike, si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast duhet të jetë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse, Udhëzimi nr. 3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.*
- b) *Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në Vendimin nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe në Vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civil”, të paraqesë përpara njësisë përgjegjëse, propozimet për lirin nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve, pozicioni i të cilëve është shkurtuar, apo është riorganizuar.*
- c) *Përmbyllja e procesit me vendimin përfundimtar për lirin nga shërbimi civil, apo riemërimin në pozicione të të njëjtës kategori, sipas dispozitave të mësipërme, do të kryhet nga njësia përgjegjëse, pasi të analizojë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit.*
- Në këtë rast, akti i emërimit duhet të jetë individual për çdo punonjës, ku të përcaktohet pozicioni i punës dhe kategoria e pagës.*
- Në rastet e transferimit të punonjësit për shkak të ristrukturimit, duhet të merret mendimi i tij me shkrim për pranimin, ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në Vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civil”.*
- d) *Të hartohen dhe plotësohen përshkrimet e punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi kjo përbën një kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, i cili ka për detyrë të bëjë krahasimin e kërkesave specifike të pozicioneve të punës me cilësitë dhe kualifikimet e çdo nëpunësi e pas kësaj, të bëjë propozimin përkatës për transferimin apo lirin e secilit nëpunës.*

Në rastet e lirimit nga shërbimi civil, për shkak të shkurtimit apo riorganizimit të vendit të punës, në aktin e lirimit të punonjësit, të shënohen të drejtat që rrjedhin nga pikat 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, të ndryshuar, siç është e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë dhe e drejta që, brenda një periudhe 2 vjeçare, të konkurrojnë për procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t’u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

- 15.** *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 45 ditë nga marrja dijoni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në detyrat dhe orientimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 98, datë 25.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Pukë”, me Vendimin Nr. 205, datë 12.10.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 98, datë 25.04.2017, ‘Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Pukë’”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka, Joni Marko dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 17.10.2017, u paraqitën pranë institucionit të Bashkisë Pukë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Pukë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr.1696/2 prot., datë 12.10.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohnin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmëruar. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 24.10.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe i nënshkruar nga personi i kontaktit të institucionit të Bashkisë Pukë në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës dhe Zhvillimit Turistik.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikën 2 të vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë që të nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës Civil” apo “Nëpunës Civil në periudhë prove” për punonjësit *****
***** dhe *****
pas të ketë verifikuar përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme të tyre me kërkesat specifike që përmban secili prej vendeve të punës.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Pukë, pasi verifikoi kriteret e përgjithshme e të posaçme të punonjësit *****
konkludoi se ky punonjës ishte me arsim të mesëm, ndërkohë që për këtë pozicion pune kërkohej arsim i lartë. Për këtë arsye, njësia përgjegjëse nuk e ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këtë punonjës, i cili në momentin e verifikimit në subjekt vazhdonte marrëdhënien e punësimit në të njëjtin pozicion pune. Sipas njësisë përgjegjëse, kjo situatë ka ardhur si pasojë e mungesës së kapaciteteve njerëzore. Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, pika 18 e tij: “Në raste të veçanta, në bashkitë me deri në 20 000 banorë, kur, për mungesë kapacitetesh, ka punonjës që nuk kanë arsimin e lartë dhe punojnë në pozicione të nivelit ekzekutiv të shërbimit civil, pagat e tyre caktohen nga këshillat përkatës, në kufirin maksimal deri në 39 000 lekë në muaj.”

Për punonjëset *****
***** (e cila rezulton se ka arsimin përkatës) dhe *****
njësia përgjegjëse nuk i ka nxjerrë ende aktet e deklarimit të statusit të punësimit.

Në pikën 3 të vendimit paralajmërues dhe rekomandimeve të Komisionerit në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, njësisë përgjegjëse, pranë Bashkisë Pukë i është lënë detyrë që të përfundojë marrëdhënien e punësimit për punonjësit *****
***** dhe *****
duke evidentuar faktin e mospërmbushjes së kriterit të nivelit arsimor.

Nga verifikimi në subjekt rezultoi se njësia përgjegjëse nuk ka përfunduar marrëdhënien e punësimit për këta punonjës, pasi pozicionet “Arkiviste” dhe “Specialist teknik”, të mbajtura respektivisht prej tyre, nuk përfshihen më në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Pukë, njësive administrative institucioneve në varësi dhe funksioneve të deleguara për vitin 2017”, këto pozicione kanë ndryshuar emërtesë në “Punonjës Arkive” dhe “Teknik Ndërtimi”.

Në pikat 4 dhe 5 të vendimit, njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë i është kërkuar anulimi i akteve të emërimit, që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit për 10 punonjësit e Bashkisë Pukë (*****

***** dhe *****
***** dhe për punonjësit e njësive administrative: Gjegjan (*****
***** dhe *****).

(*****), ***** dhe *****), Qelëz (*****), ***** dhe *****) dhe Rrapë (***** dhe *****).

Gjatë verifikimit në subjekt, u konstatua se nga ana e Bashkisë Pukë nuk janë anuluar aktet e emërimit për punonjësit e përmendur më sipër.

Me aktin nr. 1565 prot., datë 18.10.2017, “*Dërgojmë shpallje për vend të lirë pune, Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Zhvillimit të Turizmit dhe Marrëdhënieve me Publikun*”, në Bashkinë Pukë, është bërë publike në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit akti i shpalljes për këtë pozicion pune (*i cili mbahej nga punonjësja ******).

Për punonjësen ***** me detyrë, “*Specialiste Finance*”, në Bashkinë Pukë, njësia përgjegjëse ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me urdhrin nr. 205, datë 22.07.2016.

Në Njësinë Administrative Gjegjan:

Njësia përgjegjëse nuk ka përfunduar marrëdhënien e punësimit për punonjësin ***** pas pozicioni “*Specialist Pyjesh*”, i mbajtur prej tij, nuk përfshihet më në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Pukë, njësive administrative institucioneve në varësi dhe funksioneve të deleguara për vitin 2017*”, ky pozicion ka ndryshuar emërtesë në “*Teknik Pyjesh*”.

Në Njësinë Administrative Qerret:

Kryetari i Bashkisë, me urdhrin nr. 210, datë 01.08.2017, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare*”, ka bërë ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënies të punës për punonjësin ***** si rezultat i braktisjes së vendit të punës.

Bazuar në nenin 57 pika 3 ç) të Ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, braktiksja e vendit të punës konsiderohet shkelje e rëndë. Në nenin 59 të këtij ligji, parashikohet se autoriteti kompetent për marrjen e masës disiplinore në një rast të tillë është komisioni disiplinor (*i cili duhet të ngrihet në përputhje me parashikimet e Vendimit Nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”). Në kushtet kur, Kryetari i Bashkisë Pukë ka vepruar në mungesë të kompetencës, në kundërshtim me parashikimet ligjore, bazuar në nenet 108 dhe 109 të Ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, urdhri nr. 210, datë 01.08.2017, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare*”, për punonjësin ***** është një akt administrativ i paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm në të njëjtën kohë. Por duke qenë se akti i

emërimit të këtij punonjësi është një akt absolutisht i pavlefshëm, nuk është e nevojshme që procedura e mësipërme të anulohet, pasi pasoja është zgjidhur.

Në Njësinë Administrative Qelëz:

Për punonjësin, *****, në pozicionin, “*Specialist Finance*”, njësia përgjegjëse ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me urdhrin nr. 340, datë 06.12.2016.

Për punonjësen, *****, në pozicionin, “*Arkiv Protokoll*”, në momentin e verifikimit rezultoi se kjo punonjëse ishte me raport leje lindje dhe njësia përgjegjëse nuk kishte marrë asnjë masë.

Në Njësinë Administrative Rrapë:

Për punonjësin *****, në pozicionin, “*Specialist i Tatim Taksave*”, njësia përgjegjëse ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me urdhrin nr.23, datë 06.02.2017.

Për punonjësit e bashkisë (*****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****, *****) dhe njësite administrative: Gjegjan (***** dhe *****), Qerret (***** dhe *****), Qelëz (*****) dhe Rrapë (*****), për të cilët në momentin e verifikimit vazhdonte marrëdhënia e punësimit, me shkresën nr. 1566 prot., datë 18.10.2017, njësia përgjegjëse i ka njoftuar se marrëdhënia e tyre e punësimit do të vazhdojë deri në momentin e përfundimit të procedurës së konkurrimit për pozicionet e mbajtura prej tyre. Sipas njësisë së burimeve njerëzore, një veprim i tillë është kryer për të mos krijuar pengesa në mbarëvajtjen e punëve të institucionit, për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore. Pavarësisht sa më sipër, njësia përgjegjëse duhet të marrë masa që fillimisht këto pozicione t’i shpalli si të lira në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore, duke u kujdesur që të ndjekë me përpikmëri të gjitha hapat proceduralë të nevojshëm për finalizimin e kësaj procedure.

Në pikën 6 të vendimit paralajmërues Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që të trajtojë si pjesë e shërbimit civil dhe të plotësojë nëpërmjet procedurës së konkurrimit pozicionet: në Bashkinë Pukë: “*Përgjegjës i Sektorit Urbanistik dhe Regjistrimit të Pasurive*”, “*Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm*” dhe 2 pozicione “*Specialist Auditues i Brendshëm*” dhe në Njësinë Administrative Qerret: “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*”, “*Specialist Tatim Taksash*” dhe “*Specialist Teknik Topograf*”.

Nga verifikimi në subjekt, rezultoi se me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016, “*Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Pukë, njësite administrative, institucioneve në varësi dhe funksioneve të deleguara për vitin 2017*”, struktura organizative e Bashkisë Pukë ka pësuar ndryshime. Konkretisht, pozicioni i punës

“Përgjegjës i Sektorit Urbanistik dhe Regjistrimit të Pasurive” nuk ekziston më në këtë strukturë. Në vend të tij është parashikuar pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor”. Gjithashtu, pozicioni “Specialist Teknik Topograf” në Njësinë Administrative Qerret nuk ekziston më.

Pozicionet e tjera (“Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm” dhe 2 pozicione “Specialist Auditues i Brendshëm” në Bashkinë Pukë dhe “Specialist i Ndhmës Ekonomike” e “Specialist Tatim Taksash” në Njësinë Administrative Qerret), duke iu referuar strukturës aktuale të Bashkisë Pukë (miratuar me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016) dhe Vendimit Nr. 6, datë 23.01.2017, “Miratimi i nivelit të pagave të Administratës së Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara të vitit 2017”, të Këshillit Bashkiak, rezulton se janë konsideruar si pjesë e shërbimit civil.

Me shpalljet nr. 1563 prot., dhe nr. 1564 prot., datë 18.10.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njësia përgjegjëse ka filluar procedurat e konkurrimit për pozicionet “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm” dhe “Specialist i Sektorit të Auditit të Brendshëm”. Këto procedura duhet të shpallen edhe për pjesën tjetër të pozicioneve të trajtuara në pikën 6 të vendimit, të cituara më sipër. Në përfundim të këtyre procedurave, njësia përgjegjëse duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin dhe të dërgojë bashkëlidhur të gjitha aktet që materializojnë finalizimin e procesit në përputhje me ligjin dhe rekomandimin e Komisionerit.

Në pikën 7 të vendimit, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Pukë, që të hartojë menjëherë përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet që i përkasin shërbimit civil. Gjatë verifikimit në subjekt, grupi i punës konstatoi se kishte filluar puna për hartimin e përshkrimeve, të cilat ishin hartuar për një pjesë të pozicioneve por nuk ishin miratuar ende. Ky proces duhet të përmbyllet sa më shpejt nga njësia përgjegjëse, e cila me finalizimin e tij duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin, duke i bashkëngjitur edhe aktet përkatëse.

Në pikën 8 të vendimit, Komisioneri i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të kryejë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për të gjithë punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i gjeti në punë dhe sipas nenit 67 të këtij ligji përfituan statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit, duke e realizuar këtë proces edhe për vitet 2015 dhe 2016.

Nga verifikimi në subjekt, grupi i punës konstatoi se njësia përgjegjëse e kishte realizuar procesin e vlerësimit të rezultateve në punë në përputhje me rekomandimet e Komisionerit. Konkretisht, procesi i vlerësimit ishte kryer për vitet 2015, 2016 dhe 2017, në përputhje me formatin standard të miratuar dhe përcaktimet ligjore e nënligjore përkatëse (grupi i punës administroi 1 vlerësim të rezultateve në punë për secilin nga vitet).

Në pikën 9 të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse që të trajtojë si pjesë e shërbimit civil pozicionet: “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*” dhe “*Specialist Tatim Taksash*” në Njësinë Administrative Qerret; “*Specialist i Arkivës*”, “*Specialist i Tatim Taksave*”, “*Përgjegjës Finance*” dhe “*Përgjegjës i Shërbimit Pyjor, Ndhmës Ekonomike dhe Kadastrës*” në Njësinë Administrative Rrapë, dhe të hartojë planin vjetor për vitin 2017, duke mbajtur parasysh nevojat për rekrutime të reja që do të rezultojnë nga struktura përfundimtare e vitit 2017.

Duke iu referuar strukturës së Bashkisë Pukë për vitin 2017 (*miratuar me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016*) dhe Vendimit Nr. 6, datë 23.01.2017, “*Miratimi i nivelit të pagave të Administratës së Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara të vitit 2017*”, të Këshillit Bashkiak, rezulton se pozicionet: “*Specialist i Ndhmës Ekonomike*” dhe “*Specialist Tatim Taksash*” në Njësinë Administrative Qerret; “*Specialist i Arkivës*” dhe “*Specialist i Tatim Taksave*” në Njësinë Administrative Rrapë janë konsideruar si pjesë e shërbimit civil. Pozicionet “*Përgjegjës Finance*” dhe “*Përgjegjës i Shërbimit Pyjor, Ndhmës Ekonomike dhe Kadastrës*” në Njësinë Administrative Rrapë nuk ekzistojnë më në strukturën aktuale të Bashkisë Pukë.

Me Urdhin Nr. 296, datë 31.10.2017, është miratuar plani i pranimit në shërbimin civil për vitin 2017, në të cilin janë përfshirë edhe pozicionet e reja që rezultuan të lira pas miratimit të strukturës përfundimtar të institucionit me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016.

Në pikën 10 të vendimit, njësisë së burimeve njerëzore i është lënë detyrë që të përfundojë marrëdhëniet e punësimit, duke evidentuar faktin e mospërbushjes së kriterit të nivelit arsimor për punonjësit: *****, me detyrë “*Arkivist*” në Njësinë Administrative Gjegjan dhe *****, me detyrë “*Arshivë dhe Protokoll*”, në Njësinë Administrative Rrapë dhe pozicionet e mbajtura prej tyre t’i shpallë të lira, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin.

Duke iu referuar strukturës së Bashkisë Pukë për vitin 2017 (*miratuar me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016*) dhe Vendimit Nr. 6, datë 23.01.2017, “*Miratimi i nivelit të pagave të Administratës së Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara të vitit 2017*”, të Këshillit Bashkiak, rezulton se pozicioni “*Arkivist*” në Njësinë Administrative Gjegjan ka ndryshuar emërtesë në “*Punonjës arkive*”, pozicion pune i cili nuk përfshihet në fushën e veprimt të ligjit për shërbimin civil.

Për punonjësin *****, rezulton se njësia përgjegjëse nuk e ka përfunduar marrëdhënien e punës, sikundër ishte lënë detyrë në dispozitivin e vendimit të Komisionerit, por me shkresën nr. 1566 prot., datë 18.10.2017, “*Njoftim për vazhdimin e marrëdhënieve tuaja të punës deri në përfundim e kryerjes së procedurat të konkurrimit*”, e ka njoftuar atë se marrëdhënia e tij e punësimit do të vazhdojë deri në

momentin e përfundimit të procedurës së konkurrimit. Sikundër është parashtruar edhe më sipër, një veprim i tillë është kryer për të mos krijuar pengesa në mbarëvajtjen e punëve të institucionit, për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore.

Në pikën 11 të vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka lënë detyrë njësisë përgjegjëse që në rastin e nëpunëses *****, të plotësojë mangësitë e aktit administrativ nr. 610/10, datë 09.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë, në respektim të pikës 8, të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe t’i japë shpërblimin sipas vjetërsisë në shërbimin civil.

Nga verifikimi në subjekt, grupit të punës nuk iu vu në dispozicion asnjë akt që të materializonte zbatimin e kësaj pike.

E njëjta situatë rezulton edhe sa i takon zbatimit të **pikës 12 të vendimit** paralajmërues të Komisionerit, në të cilën njësisë përgjegjëse i ishte lënë detyrë që të plotësonte dosjet e personelit në përputhje me konstatimet e evidentuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes dhe anekset bashkëlidhur tij. Grupi i punës konstatoi se edhe ky rekomandim nuk ishte zbatuar nga njësia përgjegjëse.

Në pikën 13 të vendimit, njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë, i ishte lënë detyrë që, në strukturën përfundimtare, të bënte një ndarje të qartë mes pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil dhe funksioneve ndihmëse administrative.

Nga këqyrja e strukturës së Bashkisë Pukë për vitin 2017, miratuar me Urdhrin Nr. 367, datë 30.12.2016, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Pukë, njësive administrative institucioneve në varësi dhe funksioneve të deleguara për vitin 2017 ” dhe Vendimit Nr. 6, datë 23.01.2017, “Miratimi i nivelit të pagave të Administratës së Bashkisë Pukë, Njësive Administrative, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara të vitit 2017”, të Këshillit Bashkiak, rezulton se njësia përgjegjëse ka materializuar në këto akte ndarjen e qartë të pozicioneve në përputhje me përcaktimet e Vendimit Nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave.

Në pikën 14 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Pukë i është lënë një sërë detyrash që lidhen me procesin e ristrukturimit si: përfundimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit, ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për punonjësit që nuk përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civilë, revokimin e të gjitha akteve administrative që kanë dalë në kuadër të ristrukturimit dhe kryerjen e këtij procesi nga e para, duke ndjekur kërkesat e ligjit dhe aktet nënligjore përkatëse.

Nga verifikimi në subjekt, rezulton se njësia përgjegjëse me Urdhrin nr.10, datë 27.01.2016, “Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit” ka ngritur Komisionin e

Ristrukturimit. Kjo është e vetmja masë që njësia përgjegjëse ka marrë në lidhje me zbatimin e kësaj pike të vendimit.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 98, datë 25.04.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil në Bashkinë Pukë”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e Komisionerit. Duke mbajtur parasysh konstatimet dhe orientimet në përmbajtjen e këtij materiali, njësia përgjegjëse duhet të vazhdojë marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e plotë të Vendimit Nr. 98, datë 25.04.2017, të Komisionerit (*konkretisht të pikave 2, 4, 5, 6, 7, 10, 11, 12 dhe 14*). Problemet e evidentuara gjatë trajtimit të zbatueshmërisë së këtij vendimi, duhet të mbahen parasysh nga Kryetari i Bashkisë Pukë dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të mos përsëriten më në të ardhmen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 98, datë, datë 25.04.2017, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Pukë”*.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 4, 5, 6, 7, 10, 11, 12 dhe 14 të Vendimit Nr. 98, datë 25.04.2017, të Komisionerit .
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Pukë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha